



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



DREJTORATI PËR
BUJQËSI, PYLLTARI DHE
ZHVILLIM RURAL

08 Nr ____ / 2011

Dt. 04.10.2011

HYDRE-MLAZIN-PROJEKTI
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANI - DEÇANI MUNICIPALITY

Rga: DGPJHR-DEÇANI
Gj: 5278
Firm: Prok. No: 08
Nr i fageve: 08
Nr Stricica: 04-10-11
Nr Pjeses: 20
DEÇANI DEÇANI

Në mbështetje të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr;2003/3, si dhe Ligjit nr;03/L-153 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pyjet e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2011 për ndryshimin edhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 06/2010 lidhur me Shitjen e Trungjeve Pyjore dhe Asortimenteve Drusore nga Pyjet Publike, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Deçan shpall:

ANKAND PUBLIK

Ftohen të gjithë operatorët ekonomikë të licencuar, që janë të interesuara për blerjen e masës drunore në pyll, që të dorëzojnë ofertat e tyre për sasinë dhe asortimentin e evidentuar në tabelat si vijon:

Njësia menaxhuuese Kozhnjer – Roshkodol

Komuna	Njësia menaxhuuese	Ngastra pyjore	Lloji drurit	Sasia në m3		Çmimi fillestar €/m3		Vlera fillestare në €	
				Teknik	Zjarri	Teknik	Zjarri	Teknik	Zjarri
Deçan	"Kozhbjer - Roshkodol	8/ 9/ 10/ 11	Bredh	385.05		28,25		10,114,91	

Kriteret për të konkurruar në ankand janë:

- a) Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit.
- b) Dëshminë për përgatitjen profesionale dhe teknike- licencën për kryerjen e aktiviteteve përkatëse sipas U.A nr;03/2008 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurat për dhënien e licencave për kryerjen e punëve në pyje dhe toka pyjore
- c) Certifikatën mbi kryerjen e obligimeve tatimore nga ATK-ja jo më të vjetër se tre muaj, nga dita e aplikimit.
- d) Dëshmi të lëshuar nga Autoriteti Komunal, dhe Autoriteti Pyjor i Kosovës se kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pa kryera nga kontratat e mëhershme.
- e) Dëftesa për pagesën e shumës prej 20 €. për pjesëmarrje në ankand.

Kriteret vijuese që do të kërkohen për vlerësimin e përfituesit janë:

- a) Çmimi më i lartë i ofruar vendos 40% fituesin e tenderit
- b) Referencë-dëshmi mbi kryerjen me sukses të punëve të realizuara nga kontratat e mëhershme i hartuar sipas procesverbalit të komisionit për pranim dorëzimin e ngastrave pyjore sipas nenit 45 paragrafi 2 të U.A nr;29/2005, vendos 40% fituesin e tenderit.
- c) Dinamika më e shkurtër e propozuar në ofertë për kryerjen e punëve vendos 20% fituesin e tenderit.

Ofertuesi duhet të ofroj

- njësinë/të Menaxhuese, numrin e ngastrës dhe sasinë për të cilën paraqitet oferta.
- Çmimin e ofruar për m³ të asortimenteve drunore veç e veç për dru zjarri dhe lëndë teknike.
- Subjektet e licencuara që dëshirojnë të marrin pjesë në Ankand Publik, pesë (5) ditë para mbylljes mund të bëjnë vizita në terren në përcjellje të zyrtarëve të Drejtoratit komunal për Bujqësi,pylltari dhe zhvillim rural.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave do të jetë me datën: 10.10. 2011. Në ora 15 h.

Ofertat duhet të dorëzohen në zyrat e Drejtoratit për bujqësi,pylltari dhe zhvillim rural në pliko të mbyllura.

Hapja e ofertave do të bëhet nga Komisioni komunal në prezencë të ofertuesve me datën 11.10.2011 në ora 10 h.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky ankand përcaktohen me kontratë në mes të Drejtoratit për bujqësi,pylltari dhe zhvillim rural dhe përfituesit.

Drejtorati për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural gjatë nënshkrimit të kontratave do të përcaktoj afatin kohor për kryerjen e punëve nga operatorët ekonomik të cilët do të jenë përfitues të këtij ankandi.